



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr.126/13
Prishtinë, më 16.09.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 09.09.2013;**
- 3. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, dt. 09.09.2013

Kryetarja konstatoi se miratohet procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti

Kryetarja sqaroi amendamentin e propozuar nga Komisioni për Integritet Europian, i cili ka për qëllim që me këtë ligj t'iu njihet përvoja e punës gjatë viteve 89 – 90 punëtorëve të Kosovës të larguar me dhunë nga puna apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, të cilët kanë punuar në sistemin paralel të arsimit, shëndetësisë apo në sektorët tjerë. Ndërkaq përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pensionin kontribues është propozuar të rregullohet me akte të veçantë nënligjor. Ndërkaq amendamenti i propozuar nga komisioni funksional është që e drejta, kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues për punëtorët e larguar me dhunë nga puna apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, të rregullohet me akt të veçantë ligjor dhe nënligjor. Për amendamentin e komisionit funksional, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka pasur ndonjë vërejtje. Po ashtu amendamentin të cilin e ka propozuar komisioni funksional është në harmoni edhe me rekomandimet të cilat janë nxjerrë nga Kuvendi me datë 18.04.2013 pas mbajtjes së debatit për arsimin ku është janë nxjerr rekomandimet që Qeveria në afat përj tre mujash të hartoj ligjin e veçantë për statusin e punëtorëve arsimit shqiptarë të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990-1999. Ne si Komision edhe në takimet tjera kemi vlerësuar se me këtë ligj në mënyrë automatike nuk mund t'iu njihet e drejta për pension këtyre punëtorëve dhe kjo duhet të përcaktohet me akte ligjore apo nënligjore për kategoritë të caktuar në bazë të vlerësimit të saktë të koston buxhetore dhe ndarjes së mjeteve për realizimin e të drejtës së pensionit.

Hykmete Bajrami me të vërtetë e kuptoj situatë financiare dhe gjithçka tjetër e lexova edhe amendamentin që ardhë prej Komisionit të Integritet Europiane dhe amendamentet që kanë ardhur prej Komisionit për Legjislacion dhe pak a shumë kanë të njëjtën përmbajtje dhe më kujtohet shumë mirë fryma e debatit që ne e kemi pas për debatin për arsimin. Kemi kërkuar që punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë dhe të gjithë punëtorëve që kanë qenë të angazhuar në vitet 1989-90 t'iu njihet e drejta dhe këtë e kemi arsyetuar edhe në debat sepse nëse atyre nuk u njihet e drejta për pensione, neve nuk duhet të na njihen diplomat. Gjithashtu është rekomandimi i Kuvendit i cili ka dalë me shumicë të votave që të rregullohet me një ligj të veçantë, derisa ne nuk e kemi ligjin nuk guxojmë këtyre kategorive t'iu mohojmë të drejtën për pensione. Unë jam pro amendamentit të Komisionit për Integritet Evropiane dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion.

Latif Gashi nuk është askush kundër asaj me njoft statusin e tyre dhe nuk besoj që ka bazë ligjore me ja njoft dikujt pensionin, pa e ditur paraprakisht se a ka qenë punëtorë i arsimit apo jo. Kështu që, mos të bëjmë propagandë dhe politikë me këtë qështje.

Hykmete Bajrami këtu po shkruan shumë mirë që kriteret dhe lartësia e tyre do të rregullohen me akte nënligjore, mirëpo vetëm t'iu njihet stazhi, d.m.th që propozimi është t'ju njihet e drejta për pension, absolutisht aty nuk mundet dikush që nuk ka qenë punëtorë i arsimit të marrë pension, nëse veç një njeri e kemi duke punuar në këto institucione. Kriteret kush ka punuar dhe gjitha të tjerat rregullohen me akte nënligjore.

Latif Gashi besoi që kjo çështje e ka marrë rrugën e vet dhe duhet të përgaditet një ligj i veçantë dhe kemi gati të njëjtën situatë sikur për veteranët, të burgosurit dhe për kategoritë e tjera që paraprakisht duhet të nxirret ligji. Duhet krijuar bazën juridike duke formuar komisionet dhe të verifikohet numri i saktë i punëtorëve dhe të verifikohet saktësisht kosto buxhetore, e me vonë të nxirret ligji dhe ka mundësi që në mënyrë retroaktive të jepen pensionet.

Sali Asllanaj e vetmja arsye për të shtyer është që nëse nuk kemi mundësi financiare, asnjë arsye tjetër nuk e justifikon shtyrjen.

Naser Osmani për amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion nuk kam vërejtje absolutisht. Sa i përket amendamentit të Komisionit për Integritet Evropian mund t'iu them që kam qenë nënkryetar i qeverisë për Kosovën atëherë në këto institucione dhe tërë jetën time që kam punuar, në bazë të asaj që është propozuar nuk më njihet e drejta e stazhit ndërsa nuk e shohë vetën këtu sepse është fjala vetëm për ata që janë larguar që kanë punuar në arsim dhe shëndetësi. Por ne kemi formuar edhe institucionet e reja të cilat e kanë mbajtur jetën në Kosovë, ato janë institucione të njohura dhe atyre njerëzve duhet t'iu njihet ajo e drejtë absolutisht.

Latif Gashi ne të gjithë këtu që e dimë që kjo është iniciativë ka ardhë nga kryeministri dhe për njohurin e të gjithë kolegëve ju them që unë i kam dhjetë vite përvojë pune në ish arsimin dhe për ndryshe kam qenë edhe aktivistë i këshillave paralele të arsimit. Këtu nuk flitet për mohime të kontributit të të gjitha kategorive, mirëpo ideja është që a të shkojmë rrugë së mirë juridike me zgjedhë një herë e përgjithmonë problemin apo ti fusim këto pa pas numër të saktë të përfituesve, pa pas kritere dhe pa e ditur koston buxhetore.

Kryetarja sqaroi se detyra e Komisionit në këtë rast është të jep vlerësimin për koston buxhetore shtesë të amendamenteve që janë propozuar. Shumë pak është e rëndësishme kjo që debatojmë për çështje politike a duhet apo nuk duhet me njoft sepse ne të gjithë e dimë se duhet me u njoft, mirëpo ne për këtë moment me këtë situatë buxhetore që e kemi sa na kushtojnë këto nene buxhetit të Kosovës dhe a mundemi ne tash me thanë që këto amendamente janë pa kosto buxhetore. Nëse i përkrahim këto amendamente, në rekomandim duhet të shkruhet se janë pa kosto buxhetore, e që në fakt janë me kosto buxhetore, nëse themi kanë kosto buxhetore, ne sot nuk dimë sa është kosto buxhetore shtesë. Meqenëse kemi ardhur në këtë pozicion unë personalisht propozoj që të kërkojmë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe nga Ministria e Financave të na bëjnë kalkulim të koston buxhetore sa i kushtojnë buxhetit amendamentet e propozuara. Nëse është ndonjë shumë që mund të përballohet nga buxheti mund ta miratojmë, mirëpo nëse kjo është diçka që për momentin është e papërbalueshme për buxhetin dhe nuk është e paraparë askund, ne nuk mund ti japim vizë pozitive.

Hykmete Bajrami kryetare fjalimi ytë e arsyeton fjalimi e Saliut që tha që nuk ka arsytim tjetër përveç koston buxhetore. Ne nuk e dimë sa saktësisht sa është kostoja buxhetore edhe e vetë ligjit, qoftë edhe nëse i përjashtojmë këto dy kategori. Është e nevojshme të bëhet një analizë financiare, e ndoshta të përjashtojmë edhe ndonjë kategori se ndoshta është edhe më mirë për Buxhetin e Kosovës. Nëse amendamenti është racional duhet mbështetur dhe nuk më intereson ku gjinden mjetet ajo është e drejtë dhe përndryshe nëse nuk i përkrahim, ne po shkelim konventat e bashkësisë evropiane, si dhe po shkelim Kushtetutën e Kosovës duke ju bërë atyre një diskriminim të tillë.

Naser Osmani ne bëjmë ligje për Kosovën e jo për të tjerët ashtu siq kemi bërë ligje të tjera që kanë pas kosto buxhetore të jashtëzakonshme. Secili ligj përmban kosto buxhetore, por varet sa a është implikim i vogël apo implikim i madhë. Ajo që më intereson është të dijmë mundësinë e ndërhyrjes në amendamentin e Komisionit për Integritet Evropian, duhet mu rregullu në kuptimin e asaj që të jenë të përfshirë të gjithë kategoritë përfituese me këtë ligj. Nëse bëhet ligj i veçantë mund të veçohen kategoritë, por derisa nuk ka ligj specifik kjo duhet të figurojë.

Xhevdet Neziraj mendoj se nuk do të ishte mirë që të dalim dy tabore apo dy qëndrime të ndryshme prej komisionit të buxhetit. Po flasim për një periudhë që shumë njerëz kanë dhënë kontributë dhe të gjithë kemi vuajtur ne forma të ndryshme. Ka pasur njerëz që kanë punuar, por ka pasur edhe të atillë si unë që nuk kam mundur të punësohem, por sigurisht që kanë dhënë kontribut për këtë vend. Unë mendoj se është mirë me e pas një kosto fillestare prej ministrive përkatëse. Mirë e tha Naseri se çdo projektligj e ka

koston buxhetore se pa pare nuk mund të zbatohet ligji, por është e rëndësishme të dihet sa është ajo kosto, e madhe apo e vogël dhe si mund të sigurohen mjetet.

Naser Osmani ne botën e civilizuar këto qështje trajtohen pak me ndryshe, ku nje vend ka një numër të madh të popullsisë e qeveria merr një vendim që me e zbrit shtazin, p.sh nga 65 në 63 me qëllim që të krijohen vende të reja të punës për të rinjtë. Ne bëjmë ligje për veti dhe jo me ia bë qefin FMN-së apo dikujt tjetër.

Kryetarja unë po mendoj se është më mirë me qenë në sistem ne si shtet, edhe me e ditë ne se qka jemi duke bërë. Nëse e bëjmë një ligj duhet me e ditë se sa kushton ai për zbatim saktësisht dhe jo për afërsish dhe jo në këtë mënyrë përmendësh, pa pas asnjë evidencë. Unë mendojë që tani nuk mundemi me jap mendim as për me e refuzu as me i pranë këto amendamente.

Latif Gashi në mbledhjen e komisionit kur është shqyrtuar ky projektligj, kemi nxjerrur rekomandimin ku kemi thënë se e drejta edhe përcaktimi i kushteve kritereve për pensionë kontributpagues të moshës për punëtorët e kosovës të larguar me dhunë nga puna apo të shpallur si tepricë teknologjike pa bazë ligjore në vitet 1989/99 do të rregullohet me akt ligjor apo nënligjorë të veçantë deri me 1 korrik 2014. Asnjë institucion apo zyrtar apo nuk është kundër njohjes të kësaj vlere, por ne definitivisht mos të bim në kundërshtim me atë që e kemi rekomandue disa muaj përpara.

Hykmete Bajrami ia përkujtoj Latifit se amendamenti i komisioni për buxhet e financa, ka kaluar me shumicë të votave, e jo të gjithë kemi qenë për, dhe unë personalisht kam qenë kundër.

Sali Asllanaj në atë moment që e kemi miratu rezolutën në parlament, është dashur që qeveria me i ba këto përlllogaritje. Jeni shumë të zëshëm por ne tavolin jeni shumë kundër, e kjo duhet me u thanë haptas edhe para mediave.

Kryetarja mendimi im është që të kërkojmë nga dy ministrinë të cilat i kanë shënimet që na binë një përlllogaritje të koston buxhetore për këto amendamente të cilat janë propozuar, a do ti marrim ne parasysh ato, a nuk do ti marrim është qështja jona. Mirëpo po më duket qe pa i pasur ato kalkulime të tyre, qfardo vendimi që të marrim është vendim jo i mirë për komision për buxhet e financa.

Latif Gashi ne i kemi dy rrugë, e kemi rrugën me vazhdu me rekomandime që i ka votu ky komision dhe me i lënë institucionet tjera përkatëse të kryjnë detyren e tyre ose e kemi rrugën tjetër që të kërkojnë informata shpesh prej ministrive, që unë besoj prapë janë të pamjaftueshme, përderisa nuk është i planifikuar buxheti, kot e dim koston buxhetore.

Naser Osmani në amendamentin e komisionit për integritet evropiane, mendoj që duhet shtuar teksti “që edhe të punëtorët tjerë që kanë punuar në institucionet e sistemit paralel” dhe e qesim në dispozitat kalimtare që ky nen hyn në fuqi në fund të vitit 2015 apo në vitin 2016. Deri atëherë janë dy vite dhe grumbullohen mjetet materiale.

Hasime Krasniqi mendoj edhe vlerësoj se e vetmja qështje Kuvendi ka qenë më unikë se shumë herave tjera, ka qenë pikërisht kjo qështje. Çdo kush e përkrah që për periudhën në fjalët duhet të njifet e drejta për pension të gjitha kategorive që kanë punuar dhe kontribuar për këtë vend, mirëpo ashtu siç e ceku edhe kryetarja janë rekomandimet e Kuvendit me rastin e debatit për arsimin, që e drejta në pension kontributpagues të rregullohet me ligje të veçanta, dhe unë mendojë që duhet të përfshihen të gjithë njerëzit që kanë kontribuar, dhe e jo vetëm punëtorët e shëndetësisë dhe të arsimit. Po ashtu pajtohem me

kërkesën që ministritë përkatëse të na dërgojnë informatat dhe sqarimet e nevojshem lidhur me koston buxhetore shtesë të amendamenteve të propozuara, dhe të shohim se a mund ti përballoj buxheti i Kosovës dhe pastaj të dalim me qëndrim si komision.

Kryetarja ripërseriti propozimin që të kërkohet prej ministrive përkatëse që deri të enjten të na sjellin informacionet lidhur me koston buxhetore të amendamenteve dhe pastaj ne mund të mbajm një mbledhje të premten dhe pastaj të dalim me rekomandime që janë bindëse, edhe nëse e pranojmë edhe nëse e refuzojmë, por në Kuvend do të ishte mirë të jemi bindës si komision.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

Kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që më së voni deri më 19.09.2013 (e enjte), të na dërgoni me shkrim vlerësimin e ministrive përkatëse lidhur me ndikimin financiar për amendamentin e propozuar nga Komisioni për Integritet Evropian dhe tre amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion.

4. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi për Përfundimin që ka nxjerrë Kryesia e Kuvendit, ku thuhet se në pajtim e vërejtjet e Raportit të Kongresit kërkohet nga institucionet relevante të sigurohet një pavarësi buxhetore për Kuvendi në që ne vitet në vijimë 2014, 2015, 2016. Si Kuvend dhe si komision kemi qenë të ftuar në një takim që është mbajtur në mes përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe institucioneve të Kosovës, ku është diskutuar për të arriturat e Raportit të Progresit, mirëpo atë ditë kemi pas një seancë të rëndësishme dhe nuk kam arritur të marrë pjesë dhe kemi dërguar një shkresë në lidhje me qështjen që është ngritur për autonominë buxhetore të Kuvendit. Kemi sqaruar se kërkesat buxhetore të Kuvendit për vitin 2013 janë trajtuar sipas procedurave, dhe Qeveria nuk ka pasur ndërhyrje në kërkesat buxhetore të Kuvendit. Po ashtu është sqaruar se me ligjet që janë në fuqi, është obligative nga Kuvendi e nga të gjitha institucionet në qofshin ato të pavarura edhe institucionet tjera duhet t'iu përgjigjen ftesës së ministrisë së financave për dëgjime buxhetore në përpjekje të harmonizimit e kërkesave të tyre. Shkresën e keni edhe përpara dhe mendojë se duhet që këto informata t'ia dërgojmë Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi: 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj